



Prishtinë: 20/ 09/2006

Kodi i ZRrE-së: D_15_2006

Nr. i Referencës: ERO/CPD_R_08_09_06

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në Nenin 15.2 g) dhe Nenit 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
2. Kornizën ligjore të aplikueshme për llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë: “Kushtet e Përgjithshme për Dërgimin e Energjisë Elektrike” Gazeta Zyrtare e KSAK (30 Mars 1982);
3. Ankesën e bërë nga konsumatori në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e energjisë, të regjistruar me datë 18.05.2006; me numër regjistrimi 5/5 2006;
4. Procesverbalit të KEK-ut Nr. 20/3 të datës 20.05.2004;
5. Proçesit të KEK-ut Nr. 0001805 të datës 24.05.2004 mbi konstatimin e shpenzimit të jashtëligjshëm;
6. Proçesit të KEK-ut Nr. 0001806 të datës 07.06.2004;
7. Proseverbalin të KEK-ut Nr. 17 të datës 11.06.2004 që konstaton rregullimin e lidhjeve për matje korrekte të energjisë së shpenzuar;
8. Njoftimin e KEK-ut bërë konsumatorit me datë 05.10.2004 për shfrytëzim të pa autorizuar të energjisë elektrike duke dhënë edhe vlerën e dëmit të shkaktuar KEK-ut në vlerën 18,446.72 €;
9. Përgjigjen e konsumatorit drejtuar KEK-ut me Nr. 1541 të datës 12.10.2004;
10. Faturën e KEK-ut për konsumatorin 294/2004 (llogaritja e konsumit të paautorizuar/pamatur);
11. Urdhërngarkimi i kontos së konsumatorit nr 2642 të datës 05.10.2004 (KEK);
12. Skemën njëpolare të TS 10/04kV 1000 kVA;
13. Fotografitë e njehsorëve para rregullimit dhe pas rregullimit të pikës matëse të konsumatorit;
14. Përgjigjen e KEK-ut të datës 17.05.2006 në ankesën e ngritur nga konsumatori me datë 31.01.2006 (KEK);
15. Vizitën e stafit të DMK-së dhe stafit të KEK-ut në pronën dhe pikën matëse të konsumatorit;
16. Kërkesën e DMK-së bërë Divizionit të furnizimit për informacione shtesë të datës 19.06.2006;
17. Kërkesën e DMK-së bërë Mullirit Birilik për informacione shtesë të datës 19.06.2006;
18. Njoftimin e Bordit të ZRRE-së DN_01_2006 të datës 11.08.2006, dërguar palëve për plotësim të dokumentacionit;

19. Dokumentacioni i ofruar nga KEK-u (sipas kërkesës së Bordit të ZRRE-së të datës 11.08.2006);
 - a) Llogaritja e energjisë elektrike të shpenzuar në mënyrë të paautorizuar sipas procesverbalit Nr. 0001806 datë 07.06.2004;
 - b) Kontrata me konsumatorin për shërbimet e energjisë elektrike;
 - c) Kategoritë e konsumatorëve sipas pikës kyçëse; dhe
 - d) Fotot e printuara të ofruar në ZRrE dhe të dërguara përmes “flash drive”
20. Dokumentacioni i ofruar nga konsumatori në DMK (sipas kërkesës së Bordit të ZRRE-së të datës 11.08.2006): Njohtimi i Drejtorit të Mullirit “Birik” të datës 22.08.2006; konsumatori njohton ZRrE-së se ai nuk posedon të dhëna mbi prodhimin e mullirit për periudhën para dhe pas rregullimit të grupit matës të konsumatorit;
21. Rekomandimi i DMK bërë Bordit të ZRrE-së, në pajtim me Nenin 14.5 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; të datës 14.09.2006 Nr. ZRrE/DMK_R_08_09_06; dhe
22. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 20.09.2006 morri këtë:

VENDIM

Ankesa e Konsumatorit Mulliri “BIRILIK” nga fashti Mamushë komuna e Prizrenit të **REFUZOHET** për arsye të paraqitura në arsyetim të këtij Vendimi.

Arsyetimet

1. Konsumatori në ankesën e tij më 31.01.2006 ka kërkuar që të lirohet nga pagesa e ngarkuar nga KEK-u për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (procesverbali Nr. 0001805 të datës 24.05.2004) me të cilën konsumatori ngarkohet me 18,447.72 € (fatura nr. 294/2004);
2. Llogaritja nga KEK-u të shpenzimit të paregjistruar për periudhën 12 mujore para inspektimit dhe rregullimit të pikës matëse të konsumatorit është bërë si shpenzim mesatar bazuar në shpenzimet e regjistruara në tre muajt pas ndërrimit të fazave të rregullimit të pikës matëse;
3. Më 17.05.2006 Divizioni i Furnizimit në distriktin e Prizrenit (KEK) ka dhënë përgjigje konsumatorit në ankesën me datë 31.01.2006, duke informuar konsumatorin për të drejtat e tij në apelimin e vendimit të Kek-ut në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë ose në gjygin kompetent;
4. Konsumatori ka bërë apelimin në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRrE-së në faturimin e KEK-ut ngarkuar konsumatorit në vlerë prej 18,447.72 € (Fatura Nr. 294/2004);
5. Konsumatori në kërkesën e tij ka mohuar që e ka korruptuar apo intervenuar në pjesët e njehsorit;

6. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë të dokumentacioneve të ofruara nga KEK-u dhe nga konsumatori, si dhe vizitës dhe bisedave të zhvilluara në vendin e ngjarjes me përfaqësuesit e KEK-ut dhe me përfaqësuesit e konsumatorit, si dhe shqyrtimit të dokumentacioneve shtesë të ofruara pas kërkesës së Bordit të ZRRE-së; ka propozuar Bordit të ZRRE-së që të refuzoj ankesën e konsumatorit me Nr. 5/5 2006 për arsye si në vazhdim:
 - 6.1. KEK-u ka dhënë fakte me të cilat ka vërtetuar se matësi i Konsumatorit të Mullirit “BIRILIK” nga fshati Mamushë komuna e Prizrenit ka regjistruar më pak energji nga ajo e faturuar deri në momentin e intervenimit dhe rregullimit të renditjes së fazave nga ekipi i KEK-ut (Procesverbali Nr. 17 të datës 11.06.2004). Kjo dëshkohet me faturat e muajve vijues pas rregullimit të grupit matës;
 - 6.2. Kërkesa e KEK-ut për kompensim të energjisë së pamatur (shfrytëzim i paautorizuar) për 12 muaj është e bazuar në kornizën ligjore të aplikueshme në vitin 2004: “Kushtet e Përgjithshme për Dërgimin e Energjisë Elektrike” Gazeta Zyrtare e KSAK (30 Mars 1982);
 - 6.3. KEK-u ka bërë kalkulimin dhe faturimin e energjisë së pamatur (shfrytëzim i paautorizuar) bazuar në mesataren e shpenzimeve të tre mujorit të fundit (kur është rregulluar grupi matës) në vlerë prej 18,446.72 € (fatura 294/2004), me që ky kalkulim nuk ka bazë ligjore në kornizën ligjore të aplikueshme në vitin 2004. ZRRE-së ka kërkuar nga KEK-u që të bëjë rikalkulimin bazuar në kornizën ligjore të aplikueshme në vitin 2004 dhe në bazë të këtij rikalkulimi konsumatori duhet të paguaj 20, 432.03 €;
 - 6.4. Konsumatori me vetëdije apo pa vetëdije ka qenë shfrytëzues i paautorizuar i një pjesë të energjisë (2/3), andaj kjo e obligon atë që të paguaj për energjinë e shfrytëzuar sipas faturës së përgatitur nga KEK-u;
 - 6.5. KEK-u nuk ka mundur të dëshmoi se kur dhe si konsumatori ka bërë korrupsion të grupit matës, andaj nuk mund ta dënoj konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar si dhe të inicioi procedurë penale kundër konsumatorit dhe ta ngarkoj konsumatorin më shumë se vlera minimale e lejuar ligjore;
 - 6.6. Konsumatori nuk ka dëshmuar se ka pasë ndryshim të konsumit të energjisë (vëllimit të prodhimit) pas rregullimit të grupit matës të konsumatorit;
 - 6.7. Procesverbalet e paraqitura nga ekipet e KEK-ut kanë shumë dobësi, por këto dobësi nuk e përjashtojnë kërkesën e KEK-ut për të kërkuar nga konsumatori kompensimin për energjinë e shfrytëzuar të pamatur;
 - 6.8. Nga llogaritjet e bëra bazuar në Kornizën ligjore të aplikueshme në vitin 2004, DMK ka konstatuar se ngarkimi i kontos së konsumatorit me 18,446.72 është masa më e lehtë që KEK-u ka ndërmarr kundër këtij konsumatori;
7. Më 20.09.2006 Bordi i ZRRE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **ta refuzoj** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 6 të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjyqin Komunal të Prishtinës, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Bordit të ZRrE-së

Antarët e Bordit:










